FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 138

Tiranë – E mërkurë, 19 tetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 5.10.2022	Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.....	17385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 5.10.2022	Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private.....	17387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 5.10.2022	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, të pasurive të paluajtshme, në zonën kadastrale 8210, Bashkia Tiranë.....	17391
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 308, datë 12.10.2022	Për ushtrimin e detyrave si përgjegjëse për sistemin *e-Leje* në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.....	17392
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 268, datë 11.10.2022	Për miratimin e rregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median"..... ..	17393
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 26, datë 13.10.2022	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....	17399
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 549/8, datë 14.10.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Ndërtimi i linjës 110 kV Lushnjë–Fier'".....	17399

Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ferolland Kapxhiu..... 17408

Ndreqje gabimi material në vendimin e Kuvendit nr. 74/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 67/2020, 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve', i ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr.132, datë 5.10.2022..... 17408

AKT NORMATIV
Nr. 14, datë 5.10.2022

PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti dhe subjektet

1. Objekt i këtij akti normativ është përcaktimi i masave detyruese, që merren gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, me qëllim uljen e konsumit të energjisë elektrike.

2. Subjekt i këtij akti normativ janë të gjithë klientët familjarë dhe jofamiljarë, publikë dhe privatë të energjisë elektrike.

Neni 2
Qëllimi

Ky akt normativ ka për qëllim forcimin e zbatimit të masave dhe rregullave të detyrueshme për t'u zbatuar, me qëllim uljen e konsumit të energjisë elektrike, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

Neni 3
Termat e përdorur

1. Termat e përdorur në këtë akt normativ kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. "Task-Forca e Energjisë" është struktura e posaçme e ngritur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group, sh.a.

Neni 4
Ulja e konsumit nga klientët jofamiljarë publikë

1. Klientët jofamiljarë publikë zbatojnë masat e nevojshme për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike të godinave të tyre, në masën 15 % , krahasuar me muajin përkatës të një viti më parë.

2. Titullarët e institucioneve të qeverisjes qendrore, institucioneve të pavarura, institucioneve të varësisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe administratorët e shoqërive dhe ndërmarrjeve publike caktojnë me urdhër një nga punonjësit në rolin e administratorit energjetik, i cili është përgjegjës për:

a) raportimin pranë Task-Forcës së Energjisë brenda 7 (shtatë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ;

b) verifikimin e të gjitha pajisjeve që konsumojnë energji elektrike në institucion;

c) zbatimin e masave që sjellin reduktimin e energjisë elektrike së konsumuar;

ç) raportimin e konsumit të energjisë elektrike në bazë mujore te Task-Forca e Energjisë, duke identifikuar kursimet e arritura në raport me muajin përkatës të vitit paraardhës dhe raportimin e masave të zbatuara.

3. Administratori energjetik raporton në mënyrë periodike te titullari i institucionit apo administratori i shoqërisë dhe ndërmarrjes për kursimin e arritur dhe masat shtesë që duhen ndërmarrë.

4. Mosarritja e përsëritur në dy muaj e masës së kursimit të energjisë nga institucioni, shoqëria apo ndërmarrja konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Masa administrative i vendoset titullarit të institucionit, administratorit të shoqërisë apo ndërmarrjes, që ka përgjegjësi administrimi pronën përkatëse.

Neni 5
Masat e veçanta për klientët jofamiljarë publikë

1. Klientët jofamiljarë publikë, përveç detyrimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij akti normativ, zbatojnë edhe masat e detyrueshme për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të mëposhtme:

a) Ndalohet përdorimi i ajrit të kondicionuar në temperaturë më të ulët se 27 gradë gjatë verës dhe më të lartë se 21 gradë gjatë dimrit;

b) Ndërpritet ndriçimi i jashtëm i godinave të klientëve jofamiljarë publikë çdo ditë pas orës 22:00;

c) Ndërpritet ndriçimi rrugor i rrugëve ndërqytetase kryesore dhe dytësore;

ç) Ndërpritet ndriçimi i jashtëm i objekteve të kulturës, monumenteve, shesheve, shatërvanëve.

2. Nga zbatimi i pikës 1, të këtij neni, përjashtohet ndriçimi i rrugëve të qytetit.

3. Shkelja e detyrimeve të këtij neni konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Masa administrative i vendoset titullarit të institucionit, administratorit të shoqërisë apo ndërmarrjes, që ka përgjegjësi administrimi pronën përkatëse.

Neni 6
Masat e veçanta për klientët familjarë dhe jofamiljarë privatë

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, në varësi të situatës miraton masa të detyrueshme për t'u zbatuar nga klientët familjarë dhe jofamiljarë privatë.

Neni 7
Masat e financimit për klientët familjarë për kursimin e energjisë nga panelet diellore

1. Agjencia për Eficiencën e Energjisë financon projektet për instalimin e paneleve diellore, për ngrohjen e ujit sanitar për klientët familjarë. Financimi përfshin jo më shumë se 70% të vlerës së impiantit dhe kostos së instalimit. Financimi i masës mbështetëse bëhet vetëm nga të ardhurat për shërbime ndaj të tretëve, të arkëtuara nga agjencia gjatë vitit buxhetor. Fondet e pashfrytëzuara për këtë qëllim mbarten në vitin pasardhës.

2. Agjencia për Eficiencën e Energjisë publikon në fazën e parë të procesit subjektet, që kanë shfaqur interes për ofrimin e shërbimit të shitjes dhe të instalimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit të ngrohtë.

3. Agjencia për Eficincën e Energjisë në fazën e dytë realizon një procedurë të thjeshtuar për përfitimin e financimit nga klientët familjarë. Përzgjedhja e klientëve familjarë bëhet duke marrë për bazë kohën e aplikimit.

4. Instalimi i paneleve diellore monitorohet nga Task-Forca e Energjisë.

5. Agjencia për Eficiencën e Energjisë shpall në faqen e internetit rregullat dhe procedurat e detajuara për përfitimin e financimit.

6. Rregullat, procedurat dhe metodologjia për subjektet dhe klientët familjarë, objekt të kësaj mase mbështetëse, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë.

Neni 8
Masa të tjera financimi për eficiencën e energjisë

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton masa shtesë financimi për projekte eficience energjie për klientët familjarë dhe jofamiljarë, privatë ose publikë.

2. Financimi për masat e eficiencës financohet nga buxheti i shtetit ose nga donacione apo financime nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. Financimi për masat e eficiencës nga buxheti i shtetit realizohet në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

Neni 9
Organet kompetente për dhënien e masave administrative

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative, sipas përcaktimeve të këtij akti normativ, e ka Task-Forca e Energjisë.

2. Masat administrative të dhëna, sipas këtij akti normativ, përbëjnë titull ekzekutiv dhe modeli i tyre përcaktohet nga organi kompetent.

3. Shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 10
Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Ky akt normativ ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

2. Ky akt normativ nuk është i zbatueshëm për institucionet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, shkollat, kopshtet, komisariatet e policisë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 646, datë 5.10.2022

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET MBËSHTETJES FINANCIARE TË OFRUAR, SIPAS PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT, PËR KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL TË ORGANIZUARA NGA INSTITUCIONET E FORMIMIT PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, në përputhje me pikat 2 dhe 4, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit".

Neni 2

1. Procedurat e konkurrimit të parashikuara në këtë vendim për ofrimin e mbështetjes financiare për kurset e formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, zbatohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (në vijim "AKPA").

2. Ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive përcakton çdo vit programet e formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare.

KREU II
RREGULLAT PËR KONKURRIMIN E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE

Neni 3

1. Kurset e formimit profesional synojnë kualifikimin dhe rikualifikimin e punëkërkuesve, me qëllim përgatitjen për integrim të shpejtë në tregun e punës dhe kanë një kohëzgjatje nga 3 deri në 12 muaj.

2. Nga mbështetja financiare përfitojnë të gjithë punëkërkuesit, si më poshtë vijon:

a) Pjesëmarrësit punëkërkues të papunë të regjistruar, sipas pikës 14 , të nenit 3, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", financohen në masën 100%, por, në asnjë rast, më të lartë se 300 000 (treqind mijë) lekë të kostos së kursit të formimit profesional;

b) Çdo pjesëmarrës punëkërkues, sipas pikave 13 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", financohet në vlerën 50% të kostos së kursit të formimit profesional, por, në asnjë rast, më të lartë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Për personat me aftësi të kufizuara, institucionit të formimit profesional, publik apo privat, i financohen elementet e përshtatjes së arsyeshme, për sa u përket programeve të veçanta të trajnimit, kurrikulës së përshtatur, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar, përgatitjen e instruktorëve për të ofruar trajnim të posaçëm për këtë kategori, deri në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë.

KREU III
KRITERET PËR KONKURRIMIN E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE

Neni 4

1. Çdo institucion, sipas pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional", që ofron kurse të formimit profesional, konkurron me anë të një kërkese për të përfituar mbështetje financiare.

2. Kërkuesi plotëson në mënyrë kumulative kriteret e përgjithshme, si më poshtë vijon:

a) të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë kombëtare ose ndërkombëtare në ofrimin e kurseve të formimit profesional;

b) të mos jetë në proces falimentimi ose likuidimi;

c) të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera;

ç) të ketë të paktën 100 kursantë të trajnuar dhe të certifikuar gjatë veprimtarisë së mëparshme të tij;

d) të zotërojë një faqe interneti aktive, ku të pasqyrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për kursantët, si katalogun e kurseve të ofruara, mënyrën e aplikimit në kurs, datat dhe afatet e zhvillimit të kursit, kurrikulën e kompetencave të kursit dhe, sipas rastit, informacionin për skemën e mbështetjes financiare për kursantët dhe tarifat përkatëse;

dh) të ketë lidhur marrëveshje me operatorë tregu për ofrimin e praktikave të punës për kursantët e certifikuar;

e) të ofrojë këshillim karriere;

ë) në rastin e personit fizik, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale. Për personat juridikë, të mos jetë i dënuar organi administrativ, aksionarët ose ortakët.

Neni 5

1. Kursi i formimit profesional, i ofruar nga institucioni i formimit profesional, publik apo privat, duhet të plotësojë kriteret teknike, si më poshtë vijon:

a) të jetë i bazuar në një program të njohur, sipas kuadrit ligjor në fuqi, për të cilin kërkuesi zotëron të drejtën e pronësisë, të përdorimit apo, sipas rastit, certifikatë ose licencë;

b) të përmbajë si kriter pranimi, të paktën dy nga tri kriteret, e mëposhtme:

i. një testim logjik;

ii. një testim teknik/praktik, në përputhje me programin e kursit që ndiqet;

iii. një intervistë me një instruktor ose ekspert të fushës specifike, për të cilën zhvillohet kursi;

c) të zhvillohet nga një ose më shumë instruktorë të cilët plotësojnë të paktën dy nga tri kriteret e mëposhtme:

i. të kenë formimin arsimor në fushën për të cilën do të trajnohen kursantët;

ii. të kenë përvojë profesionale në fushën për të cilën do të trajnohen kursantët, në përputhje me kriteret e licencimit për kursin përkatës;

iii. të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë në mësimdhënie ose ofrim trajnimesh në fushën, për të cilën do të ofrohet kursi.

2. Kërkuesi ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje partneriteti me ente shqiptare apo të huaja për plotësimin e kritereve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 4, dhe në pikën 1, të nenit 5, të kreut III, të këtij vendimi.

KREU IV
PROCEDURAT E KONKURRIMIT PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE

Neni 6

1. AKPA-ja publikon çdo vit kalendarik thirrjen për ofrimin e mbështetjes financiare dhe mundësinë për konkurrim të subjekteve të interesuara, që plotësojnë kriteret në Buletinin e Njoftimeve Publike në faqen e internetit dhe në median sociale.

2. Thirrja për konkurrim e publikuar nga AKPA-ja përmban kriteret e përgjithshme, teknike dhe të posaçme, nëse ka të tilla, në varësi të programit të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive, kriteret e vlerësimit të kërkesave të dorëzuara, vlerën e mbështetjes financiare, procedurën e konkurrimit, si dhe dokumentet për pjesëmarrjen në programin e mbështetjes financiare përmes këtij vendimi.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni për pjesëmarrjen e institucioneve të interesuara të formimit profesional në skemën e mbështetjes financiare dorëzohen nëpërmjet portalit *e-Albania*.

Dokumentet që ngarkohen në portalin *e-Albania* janë, si më poshtë vijon:

a) certifikata e regjistrimit të kërkuesit pranë organit shtetëror kompetent;

b) dëshmia për gjendjen gjyqësore të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda personit juridik;

c) dëshmia që kërkuesi nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;

ç) vërtetimi i lëshuar nga institucioni tatimor përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

d) pasqyrat financiare të audituara në 3 (tre) vjetëve të fundit;

dh) plani i detajuar i biznesit për 3 (tre) vjet;

e) deklarimi për numrin maksimal të kursantëve, që kërkohet të mbështeten nëpërmjet skemës së mbështetjes financiare;

ë) marrëveshja e partneritetit me entet shqiptare apo të huaja për mbështetjen e kurseve të formimit profesional, nëse ka;

f) lista e instruktorëve dhe mënyra e angazhimit të tyre në kursin e formimit profesional, që do të ofrohet në kuadër të skemës së mbështetjes financiare;

g) dëshmitë për kualifikimet/certifikimet/ përvojën e çdo instruktori të angazhuar në kursin e formimit profesional, që do të përfshihet në mbështetjen financiare;

gj) planin mësimor për çdo kurs, për të cilin kërkohet pranim në skemën e mbështetjes;

h) kriteret e pranimit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, të kursantëve në çdo kurs të formimit profesional, që do të jetë pjesë e mbështetjes financiare;

i) listën e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e kursantëve, si: provime, sfida teknike apo projekte;

j) mekanizmi i ngritur gjatë ose pas përfundimit të kursit të formimit profesional, për këshillimin e karrierës dhe marrëveshjet për ndërlidhjen e kursantëve me operatorët e tregut të punës;

k) modeli i certifikatës që individi merr pas përfundimit me sukses të kursit të formimit profesional;

l) vetëdeklarimi për numrin e kursantëve të certifikuar gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit dhe për shkallën/nivelin e punësimit;

ll) tarifa e zbatueshme për secilin kurs, që do të ofrohet në kuadër të skemës së mbështetjes financiare.

4. Dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, në momentin e ngarkimit në portalin *e-Albania* duhet të jenë:

a) në gjuhën shqipe ose të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë, në origjinal ose të njësuara me origjinalin;

b) në rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj dhe të legalizuara ose të pajisura me vulë apostile, në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

1. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesave për pjesëmarrje, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKPA-së, ngrihet Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, një prej të cilëve mban pozicionin e kryetarit të komisionit.

2. Anëtarët e komisionit duhet të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën e formimit profesional ose të punësimit.

3. Komisioni i Vlerësimit ushtron detyrat e mëposhtme:

a) Administron dhe vlerëson të gjitha kërkesat e dorëzuara nga subjektet e interesuara;

b) Kërkon informacion shtesë nga subjektet e interesuara, në rastin kur dokumentet e ngarkuara në portalin *e-Albania* nuk plotësojnë kriteret e dhëna në pikën 3, të nenit 6, të këtij kreu;

c) Plotëson raportin e vlerësimit për çdo kërkesë të dorëzuar, duke përcaktuar njëkohësisht numrin e pikëve për secilën prej tyre.

4. Subjekti kërkues kualifikohet për të përfituar mbështetje financiare, nëse kërkesa e dorëzuar prej tij vlerësohet me të paktën 70 pikë për metodologjinë e mëposhtme të vlerësimit:

a) Kapacitetet për ofrimin e kursit të formimit profesional, sipas kritereve të përgjithshme dhe teknike, ku përfshihet përvoja, infrastruktura fizike,

teknike, platforma dhe licencat, si dhe kapacitetet e stafit trajnues vlerësohen deri në 60 pikë;

b) Plani i biznesit vlerësohet deri në 20 pikë;

c) Mekanizmi i ngritur për këshillimin e karrierës dhe marrëveshjet për ndërlidhjen e kursantëve me tregun e punës vlerësohen deri në 20 pikë.

5. Vendimi për kualifikimin ose jo të kërkesave për mbështetje financiare bazohet në mesataren e pikëzimit individual të çdo kërkese nga të tre anëtarët e Komisionit të Vlerësimit.

6. Komisioni i Vlerësimit në AKPA përpilon listën e institucioneve të formimit profesional, publike apo private, të kualifikuara bazuar në rezultatet e vlerësimit të kërkesave dhe njofton fituesin përmes postës elektronike. Lista e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të internetit të AKPA-së.

7. Ankimimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit për listën përfundimtare të institucioneve përfituesve të mbështetjes financiare nga subjektet e interesuara bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 8

1. Kërkesa për pjesëmarrje si kursant në kurset e formimit profesional, për të cilat ofrohet mbështetja financiare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, bëhet nga individi nëpërmjet llogarisë së tij në shërbimin përkatës në portalin *e-Albania*, pasi ka bërë regjistrimin si punëkërkues.

2. Zyra rajonale/vendore e punësimit bën verifikimin paraprak të përmbushjes së kritereve të kërkesës, të përcaktuara në shpalljen e miratuar, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi, për punëkërkuesit dhe i referon tek institucionet e formimit profesional, publike apo private, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

3. Institucionet e formimit profesional, publike apo private, përzgjedhin kursantët në bazë të kritereve të pranimit të tyre, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.

4. Struktura rajonale/vendore e punësimit, institucioni i formimit profesional, publik apo privat dhe çdo kursant pjesëmarrës lidh një marrëveshje trepalëshe, sipas formatit të caktuar në rregulloren, sipas pikës 1, të nenit 11, të këtij vendimi.

5. Disbursimi i financimit tek institucioni bëhet nga struktura rajonale/vendore e punësimit, në bazë të raportimit për ndjekjen e kursit të formimit profesional për secilin kursant, kërkesës për kalim fondesh, së bashku me konfirmimin që kursanti ka përmbyllur me sukses pjesën takuese të pagesës, në rastin kur aplikohet.

6. Kursanti ngarkohet me detyrimin e kthimit të mbështetjes financiare të përfituar, në rastet kur:

a) ndërpret pa shkak të arsyeshëm kursin e formimit profesional;

b) përjashtohet nga kursi i formimit profesional;

c) nuk përmbyll kursin e formimit profesional brenda afateve kohore të parashikuara.

7. Një punëkërkues mund të marrë pjesë vetëm një herë në një kurs formimi profesional, që i përket një programi të miratuar, sipas pikës 2, të nenit 2, të këtij vendimi.

8. Institucioni i formimit profesional, publik apo privat, dërgon pranë strukturës rajonale/vendore të punësimit listën e kursantëve të certifikuar që vërteton përfundimin e kursit me sukses, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpërndarja e certifikatave.

Neni 9

1. Kursantët, të cilët përfitojnë nga ky vendim kanë detyrimin të qëndrojnë dhe të kërkojnë punë brenda Republikës së Shqipërisë, për një periudhë jo më pak se 2-vjeçare, menjëherë pas mbarimit të kursit, në të kundërt janë të detyruar të kthejnë 100% të vlerës së mbështetjes financiare të përfituar, sipas skemës së përcaktuar në këtë vendim.

2. Niveli i punësimit të të certifikuarve nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, përfitues të mbështetjes financiare duhet të jetë jo më pak se 50% brenda 6 (gjashtë) muajve nga certifikimi. Në rast se niveli i punësimit është më pak nga parashikimi i dhënë më sipër, institucioni i formimit profesional publik apo privat fitues humb të drejtën e mbështetjes së mëtejshme në thirrjen pasardhëse për kursin e formimit profesional, për të cilin është dhënë mbështetja financiare.

3. Në rast se nuk përmbushet niveli i punësimit të kursantëve, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk kthehet mbështetja financiare e përfituar.

4. Pranimi i kërkesave nga institucionet e formimit profesional, publik apo privat, bëhet brenda fondit të alokuar, sipas programit të miratuar, sipas pikës 2, të nenit 2, të këtij vendimi.

5. AKPA-ja nëpërmjet strukturave të saj monitoron institucionet publike apo private të formimit profesional gjatë zbatimit dhe në përfundim të kursit.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

1. AKPA-ja përgatit raportin vjetor të monitorimit, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse.

2. Vlerësimi i ndikimit të skemës së mbështetjes financiare bëhet çdo dy vjet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe aftësive.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në programin "Tregu i punës", të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 11

1. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i AKPA-së për nxjerrjen e rregullores së detajuar, për mënyrën e zbatimit të këtij vendimi, duke përfshirë procedurën e monitorimit, formatin e marrëveshjes trepalëshe, në zbatim të pikës 4, të nenit 8, të këtij vendimi, si dhe thirrjen për konkurrim, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 648, datë 5.10.2022

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, NË ZONËN KADASTRALE 8210, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 117, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, të pasurive të paluajtshme, në zonën kadastrale 8210, Bashkia Tiranë, të përcaktuara në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuritë e paluajtshme, pas kalimit në përgjegjësi administrimi, përdoren në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Universitetit të Sporteve të Tiranës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur këtij vendimi, t'i tjetërsojë apo t'ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Arsimit dhe Sportit
Universiteti i Sporteve të Tiranës

Identifikoi: Ing.Sokol Allaraj

Fusha e perdorimit te Prones: Arsim Publik

Supervizoi: Mirlinda Galushi
Administrator

Aprovoi: Prof.Dr.Agron Kasa
Rektor

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones m2	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8210(TR-N-8)	3/61	Rrugë	Rrugë e brendshme Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	288.9		Rrugë	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
2	8210(TR-N-8)	3/62	Trotuar	Trotuar i brendshëm Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	111.74		Trotuar	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
3	8210(TR-N-8)	3/56	Truall	Truall (Laboratori i Fizioterapisë) Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	1106.6		Truall	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	Mbi këtë truall ka ndërtesë pa leje Laborater i fizioterapisë është deklaruar sipas shkresës nr. 404/1 datë 29.07.2014
4	8210(TR-N-8)	3/178	Truall	Fushat e Tenisit Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	1424.94		Fushat e tenisit dhe truall	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
5	8210(TR-N-8)	3/186	Truall/Ndërtesa	Truall /Ndërtesa Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	5068.56	2638.57	Administrate dhe aktivitet arsimor dhe sportiv	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
6	8210(TR-N-8)	3/176	Terren sportiv	Fushë minifutbolli Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	631.68		Terren sportiv	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
7	8210(TR-N-8)	3/177	Terren sportiv	Terren sportiv Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	676.45		Terren sportiv ndihmës	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
8	8210(TR-N-8)	3/185	Terren sportiv	Terren sportiv Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	7239.44		Pista e atletikes dhe truall	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
9	8210(TR-N-8)	3/203	Terren sportiv	Fusha e futbollit Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	10148.69		Fusha e futbollit	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	
10	8210(TR-N-8)	3/175	Godine	Godine ,Salla e lojrave Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	1611.85		Truall nën ndërtesë	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	Palestra e Lojrave e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit KRRTI Vendim nr. 24 datë 11.02.2005
11	8210(TR-N-8)	3/220	TRUALL	Rr.Muhamet Gjollesha ,Tiranë	285.3		Truall	MAS	Universiteti i Sporteve të Tiranës	Shtet

URDHËR
Nr. 308, datë 12.10.2022

PËR USHTRIMIN E DETYRAVE SI PËRGJEGJËSE PËR SISTEMIN *E-LEJE* NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të urdhrit të Kryeministrit nr. 26, datë 3.2.2020, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", si dhe të shkresës zyrtare me nr. 2114 prot., datë 6.10.2022, me lëndë "Kërkesë",

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e znj. Pranvera Alijaja për ushtrimin e detyrave si përgjegjëse për sistemin *E-Leje*, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), krahas ushtrimit të detyrës aktuale të Specialistit në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

2. Znj. Alijaja do të ushtrojë detyrat shtesë si përgjegjëse për sistemin *E-Leje*, duke filluar nga data 13.10.2022, deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

VENDIM
Nr. 268, datë 11.10.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KOMUNIKIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË ME MEDIAN"

Bazuar në nenin 189, pika 1, germa "c", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në ligjin nr. 7756, datë 11.10.1993, "Për shtypin", të ndryshuar, në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"; në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar; në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar; rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", si dhe me propozimin e grupit të punës ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 132, datë 14.9.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.

3. U shpall në Tiranë, sot, më 11.10.2022.

KRYETAR
Alfred Balla

RREGULLORE
PËR KOMUNIKIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË ME MEDIAN

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton parime, rregulla dhe procedura të veçanta, pjesë e rregullave për marrëdhëniet me publikun të Këshillit, komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.

2. Në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje, duke synuar krijimin e lehtësirave për qasjen ndaj informacionit nga përfaqësuesit e mediave, do të ndërtohet dhe do të vihet në funksionim një rubrikë e veçantë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

3. Komunikimi, në kuptimin e kësaj rregulloreje, përfshin të gjitha mënyrat e vendosjes së kontakteve institucionale ndërmjet Këshillit dhe medias, si dhe shkëmbimin e informacionit në formë të shkruar, audio, video apo të dhëna.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Këshilli" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

b) "Kodi i Etikës së Gazetarit" është instrumenti vetërregullues i normave të etikës së gazetarëve, si dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

c) "Anëtari i caktuar i Këshillit" është anëtari i caktuar për kryerjen e detyrave, në lidhje me marrëdhëniet me publikun, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

ç) "Koordinatori për të Drejtën e Informimit" është nëpunësi i caktuar i Këshillit, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

d) "Njësia mbështetëse" është njësia përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet e Këshillit, e cila përmbush detyrimet e kësaj rregulloreje për komunikimin me median.

Neni 3
Kuadri ligjor

Kjo rregullore zbatohet në përputhje me:

a) ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;

b) ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

c) ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";

ç) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;

d) rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", miratuar me vendimin nr. 407, datë 17.12.2021.

Neni 4
Fusha e veprimit

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në sferën e komunikimit me median dhe publikun, me qëllim garantimin e pasqyrimit të qëndrimit institucional të Këshillit në funksion të transparencës në komunikimin me median dhe publikun.

2. Detyrat për komunikimin me median realizohen nga anëtari i caktuar i Këshillit, i cili asistohet nga njësia mbështetëse. Njësia mbështetëse përbëhet nga Këshilltari për marrëdhëniet me median dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit. Kjo njësi, nën mbikëqyrjen e anëtarit të caktuar të Këshillit, organizon punën brenda institucionit, me qëllim vlerësimin, përgatitjen dhe redaktimin e një informacioni përmbledhës e të qartë, i cili garanton qëndrimin transparent, profesional dhe institucional të Këshillit, në raport me median dhe publikun.

Neni 5
Parimet e komunikimit me median

Përveç sa parashikohet në nenin 91, pika 5, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, parimet e së drejtës së aksesit të mediave në informacion janë:

a) parimi i objektivitetit, llogaridhënies, profesionalizmit, besueshmërisë, ndershmërisë dhe mirëbesimit, të raportimit korrekt të lajmit;

b) parimi i prezantimit të saktë të informacionit, që nënkupton shmangien e deformimit dhe të keqinterpretimit dhe ndalimin e shpërdorimit të informacionit për komente dhe opinione, që bien ndesh me vlerat e drejtësisë dhe të një shoqërie demokratike apo që nuk kanë lidhje me vlerat e shtetit të së drejtës;

c) parimi i respektimit të pavarësisë së prokurorisë dhe i mosndërhyrjes në funksionin e saj;

ç) parimi i respektimit të solemnitetit të procedurave dhe i autoritetit të drejtësisë;

d) parimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut dhe i respektimit të mbrojtjes së të dhënave personale;

dh) parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe i sigurisë kombëtare;

e) parimi i respektimit të efektivitetit të politikave qeverisëse dhe i mosrrezikimit të funksioneve të gjyqësorit;

ë) parimi i mbrojtjes së kategorive të veçanta, si të miturit dhe viktimat, nga veprat penale;

f) parimi i respektimit të dinjitetit të prokurorëve;

g) parimi i moscenimit të efektivitetit të luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, i mbrojtjes dhe i mosdekonspirimit të dëshmitarëve, si dhe të çdo informacioni konfidencial të administruar nga organet e sistemit të prokurorisë dhe nga Këshilli;

gj) parimi i transparencës;

h) parimi i ligjshmërisë;

i) parimi i respektimit të etikës;

j) parimi i respektimit të shtetit të së drejtës;

k) parimi i mirëkuptimit dhe i bashkëpunimit, në funksion të harmonizimit të vlerave të rolit të lirisë së shtypit dhe drejtësisë, si përbërës thelbësorë të një shoqërie të lirë dhe demokratike.

KREU II
KOMUNIKIMI ME MEDIAN

Neni 6
Përfaqësimi me median

1. Kontaktet e Këshillit me përfaqësuesit e medias do të mbahen nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, vetëm sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e anëtarit të caktuar nga Këshilli, i cili miraton paraprakisht çdo informacion që i përcillet medias.

2. Vendosja e kontaktit dhe komunikimi i mëtejshëm me median realizohet nëpërmjet një adrese të posaçme të postës elektronike *(e-mail):* info@,klp.al, e cila përdoret nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit.

3. Në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktohet një rubrikë e veçantë me emërtimin "Kontakti me median".

4. Gazetarët mund të paraqesin kërkesën e tyre edhe nëpërmjet një formulari, sipas modelit të lidhjes 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Informacioni që duhet të plotësohet në këtë formular nga gazetari lidhet me të dhënat personale, institucionin që përfaqëson, qëllimin dhe përmbajtjen e shkurtër të problematikës. Formulari i kontaktit vendoset në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Për çështje që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, me objektiva të rëndësishëm të politikave qeverisëse dhe funksionet e Këshillit, të mbarëvajtjes së reformës në drejtësi, ngjarje me rëndësi kombëtare dhe me rëndësi për të gjithë sistemin e drejtësisë ose për çështje të tjera që kanë të bëjnë me anëtarët e këtij Këshilli, komunikimi me median mund të realizohet drejtpërsëdrejti nga kryetari. Në rastet kur përfaqësimi në media lidhet me qëndrime të Këshillit, komunikimi duhet të kryhet vetëm pas konsultimeve paraprake me Këshillin.

Neni 7
Trajtimi i kërkesave

1. Anëtari i caktuar i Këshillit mbikëqyr të gjithë procedurën e brendshme të pranimit dhe trajtimit të kërkesave, dhe mbajtjes së kontakteve me median, duke informuar në mënyrë të vazhdueshme Këshillin dhe kryetarin e tij.

2. Anëtari i caktuar i Këshillit jep miratimin për fillimin e procedurës së brendshme, e cila koordinohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, për realizimin e kontaktit me median për kërkesën e paraqitur.

3. Këshilli trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj. Ky afat mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune, kur lind nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze, për të shtrirë kërkimet pranë prokurorive, si dhe kur lind nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike, përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

4. Kërkesa për informim mund të refuzohet nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj:

a) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;

b) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;

c) mbarëvajtjes së hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

ç) mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit;

d) këshillimit dhe diskutimit brenda Këshillit.

5. Kërkesa për informim mund të refuzohet edhe kur:

a) nuk është shprehur qartë ose është haptazi abuzive;

b) për informacionin e kërkuar ekziston tashmë material i publikuar prej Këshillit;

c) për informacionin e kërkuar i është dhënë informacion i mëparshëm të njëjtit kërkues;

ç) çështja për të cilën kërkohet informacion është ende në proces, e papërfunduar.

6. Në rast të refuzimit, kërkuesit i komunikohet shkaku i refuzimit në mënyrë të arsyetuar.

Neni 8
Lehtësitë për aksesin në informacion nga media

1. Këshilli zhvillon dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për çështjet me interes publik. Këshilli, vë në dispozicion një rubrikë në faqen e tij zyrtare në internet me informacion të përditësuar, që i adresohet medias, si një kategori e specializuar dhe profesionale e komunikimit të Këshillit me publikun. Rubrika hartohet e tillë, që të sigurojë informacion të paanshëm, objektiv dhe profesional, të lehtësojë vështirësitë e detyrës për median, duke i përcjellë publikut një informacion të besueshëm, lehtësisht të perceptueshëm, në lidhje me sistemin e drejtësisë, politikat dhe funksionet e Këshillit.

2. Mediat kanë të drejtë të kenë një përfaqësues të akreditуar pranë Këshillit, i cili nënshkruan një deklaratë, sipas së cilës angazhohet për trajtimin e informacionit të marrë nga Këshilli, në përputhje me kërkesat profesionale dhe parimet e kësaj rregulloreje. Akreditimi i mediave të huaja bëhet pas akreditimit të tyre nga Ministria e Jashtme, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

3. Çdo kërkesë për informacion duhet t'i drejtohet Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, i cili është përgjegjës edhe për koordinimin e sigurimit të informacionit brenda institucionit. Koordinatori për të Drejtën e Informimit, me miratimin e anëtarit të caktuar të Këshillit, ka të drejtë të kërkojë nga drejtuesi

përkatës i medias së akredituar zëvendësimin e një gazetari, nëse rezultojnë shkelje qartësisht të dallueshme të objektivitetit dhe profesionalizmit, si dhe për shkelje të Kushtetutës, ligjit, dhe të parimeve të kësaj rregulloreje.

4. Në rastin kur shkelja është publike, e rëndë apo flagrante, anëtari i caktuar nga Këshilli merr vendim për heqjen e akreditimit të gazetarit që kryen shkeljen. Vendimi i komunikohet drejtuesit të medias përkatëse, nëpërmjet Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Në këtë rast, anëtari i caktuar njofton Këshillin në mbledhjen e radhës.

5. Kërkesat për informacion do të dërgohen si rregull përmes postës elektronike, si edhe përmes telefonit, gjatë ditëve të javës, nga ora 08:00 deri në 16:00, e në raste të veçanta të karakterit të ngutshëm edhe jashtë këtij orari. Çdo kërkesë regjistrohet në protokoll dhe merr një numër të veçantë.

Neni 9
E drejta e akreditimit

Të drejtën e akreditimit e gëzojnë të gjitha mediat audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja, si dhe punonjësit e medies në profesion të lirë.

Neni 10
Personat e akredituar

Akreditimi jepet, për:
a) gazetarë;
b) fotografë (fotoreporterë);
c) ekipe xhirimi;
ç) teknikë;
d) operatorë;
dh) regjisorë;
e) kameramanë.

Neni 11
Kohëzgjatja e akreditimit

Akreditimi pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të jetë;
a) ditor;
b) javor;
c) mujor;
ç) vjetor (vit kalendarik).

Neni 12
Pajisja me kartë akreditimi

1. Dokumentacioni i paraqitur shqyrtohet nga anëtari i caktuar për mediat, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga paraqitja.

2. Në rast përmbushjeje të kritereve dhe dokumentacionit, personat pajisen me kartën e akreditimit të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Karta e akreditimit, kur kërkohet nga institucioni mediatik, përmban: emër/mbiemër; institucionin mediatik, që përfaqëson periudhën e akreditimit, funksionin që mban personi, fotografi në përmasat 4x3, numrin rendor.

4. Karta e akreditimit për punonjësit e medias në profesion të lirë përmban: emër/mbiemër, periudhën e akreditimit, fotografi në përmasat 4x3, numrin rendor.

5. Personat e akredituar gjatë qëndrimit (gazetarë dhe operatorë) në Këshill duhet të mbajnë në vend të dukshëm dokumentin identifikues me emrin e medias nga e cila vijnë.

Neni 13
Rinovimi i kartës së akreditimit

Karta e akreditimit rinovohet me kërkesë të institucionit mediatik ose të vetë punonjësit të medias në profesion të lirë.

Neni 14
Regjistri elektronik

1. Koordinatori për të Drejtën e Informimit krijon regjistrin elektronik për personat e akredituar.

2. Regjistri elektronik përmban:
a) listën e mediave audiovizive, të shkruara dhe elektronike, të akredituara në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
b) përfaqësuesit e tyre;
c) kohën e akreditimit;
ç) kontakte të nevojshme.

KREU IV
BASHKËVEPRIMI ME MEDIAN

Neni 15
Shoqërimi

Punonjësit përgjegjës për rendin dhe sigurinë e Këshillit, si dhe kur shihet e nevojshme, edhe

përfaqësues nga zyra e shtypit, sigurojnë shoqërimin e personave të akreditуar gjatë qëndrimit të tyre në ambientet e Këshillit.

Neni 16
Aktivitetet informuese

1. Këshilli komunikon në mënyrë proaktive me median dhe organizon aktivitete të përbashkëta me median dhe organizatat partnere, në lidhje me veprimtarinë e sistemit të prokurorisë.

2. Këshilli përgatit dhe shpërndan njoftime për shtyp, planifikon konferenca për shtyp dhe organizime të veçanta për median, si dhe mban një arkiv me artikuj nga media rreth sistemit të prokurorisë dhe Këshillit.

3. Këshilli krijon dhe shpërndan materiale informative dhe edukative për publikun përmes kanaleve të duhura të komunikimit, që përfshijnë ndër të tjera faqen zyrtare të internetit, median e shtypur, median elektronike dhe rrjetet sociale.

Neni 17
Paraqitja në mbledhje plenare

Personat e akreditуar pranë Këshillit, gjatë zhvillimit të mbledhjeve plenare, paraqiten me veshje etike dhe përdorimi i telefonave celular duhet bërë pas aktivizimit të gjendjes "*silent*".

Neni 18
Organizimi i intervistave

1. Organizimi i intervistave me anëtarët e Këshillit zhvillohet në bazë të kërkesës së paraqitur nga personat e akreditуar, në adresën elektronike *(e-mail):* info@klp.al.

2. Kërkesa përmban:

a) emër/mbiemër të personit që do të intervistohet;

b) çështjet konkrete për të cilat kërkohet intervista.

3. Intervista zhvillohet në datën dhe orën e caktuar nga personi intervistuar në një nga mjediset e mëposhtme:

a) në zyrën e anëtarit;

b) në zyrën e Komisionit të përhershëm ku anëtari bën pjesë.

c) në ambientet e tjera të përcaktuara nga Këshilli për intervista.

Neni 19
Organizimi i konferencave për shtyp

1. Konferencat për shtyp organizohen në ambientet e caktuara për këtë qëllim. Njoftimi për zhvillimin e konferencës bëhet jo më pak se dy orë nga momenti i mbajtjes së konferencës.

2. Koordinatori për të Drejtën e Informimit në Këshill, njofton median e akreditуar për orën dhe vendin e zhvillimit të konferencës për shtyp.

3. Koordinatori për të Drejtën e Informimit është përgjegjës për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e konferencës.

4. Koordinatori për të Drejtën e Informimit u vë në dispozicion personave të akreditуar një kopje të deklaratës, me kërkesën e tyre.

Neni 20
Pasqyrimi në media i mbledhjeve plenare të Këshillit

1. Në përputhje me nenin 190, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, mbledhjet plenare të Këshillit pasqyrohen në media, duke postuar në faqen zyrtare në internetit edhe një njoftim të shkurtër për shtyp, me përmbledhjen e çështjeve që paraqesin interes për publikun.

2. Përfaqësuesit e medias që dëshirojnë të marrin pjesë në mbledhjen plenare të Këshillit, duhet të paraqesin dokumentin e akreditimit personal dhe të identifikimit të medias që përfaqësojnë. Në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë *(on-line),* dokumenti i akreditimit personal mund të dërgohet elektronikisht.

3. Ndalohen regjistrimet audiovizuale të mbledhjeve të Këshillit, pa autorizimin paraprak të tij. Përfaqësuesit e medias që dëshirojnë të bëjnë regjistrime audiovizuale duhet të kërkojnë leje paraprake nga Këshilli, të paktën 4 orë përpara orës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Koordinatori për të Drejtën e Informimit u komunikon përfaqësuesve të medias kushtet për të cilat jepet leja, e cila mund të kufizohet ose refuzohet për arsye sigurie, ose arsye të tjera madhore.

4. Komunikimi i përfaqësuesve të medias gjatë zhvillimit të mbledhjes duhet të jetë etik dhe profesional dhe në asnjë rast nuk duhet të pengojë sadopak zhvillimin normal të saj. Drejtuesi i mbledhjes së Këshillit mund të kufizojë ose të

ndalojë këtë komunikim, nëse ai ndikon në zhvillimin normal të mbledhjes.

5. Seancat dëgjimore për procedimet disiplinore janë publike. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin me dyer të mbyllura, sipas rasteve të parashikuara në ligj.

6. Diskutimet dhe vendimmarrja nga anëtarët e Këshillit në dhomë këshillimi do të kryhen pa praninë e mediave.

7. Përpara fillimit të mbledhjes, anëtari i caktuar i Këshillit udhëzon Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, në lidhje me mundësinë e kryerjes së fotografive dhe filmimeve dhe kohëzgjatjen e tyre. Me kalimin e afatit të caktuar, kamerat dhe mikrofonat fiken dhe duhet të largohen me qetësi nga salla ku zhvillohet mbledhja.

8. Në interes të zhvillimit të rregullt të mbledhjes, regjistrimet vizuale lejohen vetëm nga një pozicion i caktuar në sallë, sipas udhëzimeve të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Në rastet e interesit të madh të mediave, drejtuesi i mbledhjes mund të kufizojë numrin e ekipeve me kamera, që do të lejohen në sallën e mbledhjeve. Këshilli mund të përcaktojë si kusht për mediat që do të kenë akses, të bashkëpunojnë për t'u shpërndarë regjistrimet mediave të tjera.

9. Këshilli do të monitorojë zbatimin korrekt të rregullave të komunikimit me median dhe merr masat e parashikuara në këtë rregullore, në rastet e shkeljes së tyre, për të garantuar zhvillimin normal të punës së tij.

10. Këshilli bën interpretimin e informacionit statistikor në një gjuhë të kuptueshme dhe në formë të përshtatshme për t'ua shpërndarë medias dhe publikut.

11. Këshilli monitoron perceptimin e publikut për veprimtarinë e tij dhe të sistemit në prokurorisë në tërësi.

12. Anëtari i caktuar i raporton Këshillit mbi zbatimin e Strategjisë së Komunikimit.

Lidhja 1

FORMULAR AKREDITIMI PËR MEDIAN

Emri dhe mbiemri:
Media:
E-mail:
Numri i telefonit:
Nënshkrimi:

Formulari plotësohet nga përfaqësuesit e mediave për marrjen e lejes për të bërë regjistrime audiovizuale në sallën e mbledhjeve të Këshillit. Në rastet kur çmohet nga Këshilltari për median, i caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, mund të shmanget nënshkrimi i formularit.

Bashkëlidhur këtij formulari duhet të jetë një kopje e dokumentit që provon identitetin, i cili duhet të përmbajë një fotografi, në të cilën përfaqësuesi i medias është qartësisht i dallueshëm.

Përveç interesit për informim të publikut, Këshilli ka detyrimin ligjor të sigurojë edhe të drejtën e privatësisë për personat e përfshirë gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme në seancë plenare, të cilët janë të pranishëm ose jo, si dhe emrat në dokumente procedurale, të cilët duhet të mbrohen dhe të mos cenohen.

Mediat duhet të sigurojnë që privatësia e të gjithë personave të përfshirë në mbledhjen plenare do të respektohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli rezervon të drejtën për të përjashtuar nga përdorimi i lehtësirave për mediat, në rast se do të shkelen rregullat e përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Vendimet e Këshillit janë të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të internetit.

Regjistrimi audio i mbledhjes plenare bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit. Përpara publikimit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, ndaj të cilëve janë vendosur masa disiplinore, përveç masës disiplinore të shkarkimit.

Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse. Edhe në këtë rast, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, ndaj të cilëve janë vendosur masa disiplinore, përveç masës disiplinore të shkarkimit.

VENDIM
Nr. 26, datë 13.10.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror"', i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b", në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror', kreu II, neni 4, pikat "a", "c", dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017, 'Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror"', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror', në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror', i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 26, datë 13.10.2022, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje agjenturale nr. 4640 "Maska e Vjetër", me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër sekret" dhe 18 (tetëmbëdhjetë) dokumente me 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

2. Dosje formulare nr. 4096, në ngarkim të M. Xh., me 20 (njëzet) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

3. Dosje formulare nr. 2189, në ngarkim të N. Sh., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër sekret" dhe 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

4. Dosje përpunimi nr. 2370, në ngarkim të Th. B., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër sekret" dhe 49 (dyzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1972-1991. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.

5. Dosje fashikullore nr. 2751, në ngarkim të N. Gj., me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret".

Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

6. Dosje personale nr. 2328, në ngarkim të I. F., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

7. Dosje përpunimi nr. 1631, në ngarkim të S. Ç., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

KRYETAR I KDZH
Gentiana Sula

KËRKESË
Nr. 549/8, datë 14.10.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Ndërtimi i linjës 110 kV Lushnjë–Fier"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "tokë arë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **423,529 (katërqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 110 kV LUSHNJË–FIER"

Nr rendor	Nr shtylle	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME			ADRESA:
										"ARË"			"ARË"			VLERA TOTALE (lekë)				
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m2)	"Trual" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		Nr. Dok.	Data e regjistrimit	Seksionet D & E të kartelës së pasurisë	
		A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	L	M	N	O	P	Q	R	RR
1	1	Nuk ka informacion				2087							26.21			0				Shkresa ASHK Lushnjë 2901/1 datë 27.05.2022
2	2	Nuk ka informacion				2087							21.34			0				Shkresa ASHK Lushnjë 2901/1 datë 27.05.2022
3	3	Petrit	Bajram	Manlla	KARBUNARE E POSHTME	2087	646/39	Arë	2395	2395			26.21	364	9540	9540				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
4	4	Nazmi	Hazis	Elezi	KARBUNARE E POSHTME	2087	651/22	Arë	1716	1716			13.8	364	5023	5023				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
5		Ferit/Shefiko	Zenun/Qatip	Lloshi	KARBUNARE E POSHTME	2087	651/24	Arë	1658	1658			5.56	364	2024	2024				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
6	6	Fadil	Sabri	Kasapi	KARBUNARE E POSHTME	2087	839/4	Arë	4620	4620			21.34	364	7768	7768				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
7	7	Abedin	Shyqyri	Sulo	KARBUNARE E POSHTME	2087	849/1	Arë	6204	6204			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
8	8	Kimete	Kadri	Kaja	KARBUNARE E POSHTME	2087	851/18	Arë	2507	2507			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
9	9	Ragi	Vangjel	Nushi	KARBUNARE E POSHTME	2087	853/8	Arë	12536	12536			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë

10	**10**	Sulejman	Rrapush	Sula	KARBUNARE E POSHTME	2087	854/7	Arë	4460	4460			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
11	**11**	Armand	Behar	Elezi	KARBUNARE E POSHTME	2087	1296/6	Arë	3430	3430			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
12	**12**	Ymer	Asllan	Sula	KARBUNARE E POSHTME	2087	1295/15	Arë	4983	4983			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
13	**13**	Fatmir	Hysni	Sula	KARBUNARE E POSHTME	2087	1295/2	Arë	3348	3348			17.14	364	6239	6239				Fshati: Karbunare e Poshtme, NJ A: Lushnjë, Bashkia Lushnjë
14	**14**	Koli/Olimbi/Emiljana/Eugen/Egla	Sotir/Llazi/Koli/Koli/Koli	Davidhi	KRUTJE E SIPËRME	2287	250/12	Arë	11008	11008			17.14	364	6239	6239				Fshati: Krutje e Sipërme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
15	**15**	Petrit	Trifon	Avrami	KRUTJE E SIPËRME	2287	251/12	Arë	7110	7110			5.4	364	1966	1966				Fshati: Krutje e Sipërme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
16		Dhimo	Vasil	Gjermeni	KRUTJE E SIPËRME	2287	251/13	Arë	9570	9570			11.74	364	4273	4273				Fshati: Krutje e Sipërme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
17	**16**	Lili	Van	Allkanjari	KRUTJE E POSHTME	2286	79/10	Arë	21432	21432			17.14	364	6239	6239				Fshati: Krutje e Poshtme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
18	**17**	Ylli	Kroni	Goga	KRUTJE E POSHTME	2286	80/16	Arë	7662	7662			17.14	364	6239	6239	02637	18.09.2017	Kerkese Padi sipas Vertetimit nr 1022 prot datë 19.8.2017 te Gjykates Lushnjë	Fshati: Krutje e Poshtme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
19	**18**	Lami	Loni	Shtëmbari	KRUTJE E POSHTME	2286	85/3	Arë	13050	13050			19.36	364	7047	7047				Fshati: Krutje e Poshtme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
20	**19**	Gori	Spiro	Gjini	KRUTJE E POSHTME	2286	116/1/1	Arë	9424	9424			21.34	364	7768	7768				Fshati: Krutje e Poshtme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
21	**20**	Përparim	Sokrat	Sota	ZHYME	3936	415/23	Arë	2000	2000			17.14	364	6239	6239				Fshati: Zhyme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
22	**21**	Ariste/Arjola/Armida	Themi/Sokrat/Sokrat	Ferati/Llupo/Llupo	ZHYME	3936	424/3	Arë	6710	6710			24.01	364	8740	8740				Fshati: Zhyme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
23	**22**	Llukan	Leksi	Llupo	ZHYME	3936	425/24	Arë	12651	12651			17.14	364	6239	6239				Fshati: Zhyme, NJ A: Krutje,

																			Bashkia Lushnjë
24	23	Stefan	Lili	Mëhilli	ZHYME	3936	436/9	Arë	4958	4958			17.14	364	6239	6239			Fshati: Zhyme, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
25	24	Josif	Dhimo	Çuko	Fier i Ri	1614	525/4	Arë	7410	7410			17.14	364	6239	6239			Fshati: Fier i Ri, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
26	26	Baki	Kasem	Zhupani	GJAZE	1724	148/6	Arë	15700	15700			17.14	364	6239	6239			Fshati: Gjaze, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
27	27	Mydeir	Baki	Sakollari	GJAZE	1724	151/6	Arë	11574.2	11574.2			17.14	364	6239	6239			Fshati: Gjaze, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
28	28	Panajot	Petro	Billo	GJAZE	1724	152/7	Arë	7504.5	7504.5			17.14	364	6239	6239			Fshati: Gjaze, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
29	29	Pali	Ndrio	Trifoni	ARREZ	1047	1/3	Arë	21960	21960			21.34	364	7768	7768			Fshati: Arrez, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
30	30	Todi	Ndrio	Trifoni	ARREZ	1047	17/2	Arë	9254	9254			17.14	364	6239	6239			Fshati: Arrez, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
31	31	Sokrat	Zoi	Qose	ARREZ	1047	29/9	Arë	6134	6134			17.14	364	6239	6239			Fshati: Arrez, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
32	32	Nuk ka informacion			ARREZ	1047	29/2+3+4 +10						24.01		0	0			Shkresa ASHK Lushnjë 2901/1 datë 27.05.2022
33	33	Viktor	Zoi	Qose	ARREZ	1047	39/2	Arë	14585	14585			17.14	364	6239	6239			Fshati: Arrez, NJ A: Krutje, Bashkia Lushnjë
34	34	Halit	Skënder	Abdurramani	KAMCISHT	2060	285/9	Arë	23979	23979			17.14	364	6239	6239			Fshati: Kamçisht, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
35	35	Naun	Pali	Velo	KAMCISHT	2060	290/2	Arë	22000	22000			17.14	364	6239	6239			Fshati: Kamçisht, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
36	36	Sotir	Lami	Bitri	KAMCISHT	2060	291/11	Arë	940	940			5.5	364	2002	2002			Fshati: Kamçisht, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
37		Petraq	Lami	Goga	KAMCISHT	2060	291/12	Arë	1558	1558			11.64	364	4237	4237			Fshati: Kamçisht, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
38	37	Miti/Mimoza/R	Vangjel/Thoma/Miti	Mëhillka	ESKAJ	1596	263/19	Arë	6862	6862			17.14	364	6239	6239			Fshati: Eskaj,

		enard																		NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
39	**38**	Florie/Rezarta/ Fation	Sulo/Kujtim/Kujtim	Bega/Arapi/Bega	ESKAJ	1596	263/7	Arë	4708	4708			17.14	364	6239	6239				Fshati: Eskaj, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
40	**39**	Xhevair	Refit	Kaja	ESKAJ	1596	383/9	Arë	3367	3367			14.64	364	5329	5329				Fshati: Eskaj, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
41		Isa	Ismail	Xhindoli	ESKAJ	1596	383/10	Arë	3605	3605			2.5	364	910	910				Fshati: Eskaj, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
42	**40**	Petraq	Mihal	Peto	ESKAJ	1596	383/30	Arë	3422	3422			17.14	364	6239	6239				Fshati: Eskaj, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
43	**41**	Viktor	Tonçi	Qose	ESKAJ	1596	383/47	Arë	4359	4359			21.34	364	7768	7768				Fshati: Eskaj, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
44	**42**	Latif	Osman	Senka	GJONAS	1755	388/5	Arë	10055	10055			17.14	364	6239	6239				Fshati: Gjonas, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
45	**43**	Shyqyri	Pasho	Kaja	GJONAS	1755	464/8	Arë	8000	8000			2.88	364	1048	1048				Fshati: Gjonas, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
46		Shaban	Bajram	Baçe	GJONAS	1755	464/9	Arë	2651	2651			14.26	364	5191	5191				Fshati: Gjonas, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
47	**44**	Sabri	Misir	Derka	GJONAS	1755	463/4	Arë	12500	12500			17.14	364	6239	6239				Fshati: Gjonas, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
48	**45**	Nuk ka informacion			GJONAS	1755	468/12						17.14		0	0				Shkresa ASHK Lushnjë 2532 datë 27.04.2022
49	**46**	Barjam	Abedin	Muça	GJONAS	1755	454/1	Arë	6000	6000			11	364	4004	4004				Fshati: Gjonas, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë
50		Bari	Abedin	Muça	GJONAS	1755	454/2	Arë	5673	5673			6.14	364	2235	2235				Fshati: Gjonas, NJ A: Bubullime, Bashkia Lushnjë

51	47	Nuk ka informacion			BUBULLIME	1295							17.14		0	0			Shkresa ASHK Lushnjë 2532 datë 27.04.2022
52	48	Ristan	Thoma	Merkuri	VERRI	3752	42/12	Arë	14940	14940			21.34	269	5740	5740	00001	24.02.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Verri, NJA: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
53	49	Arqile	Zarik	Bita	VERRI	3752	42/6	Arë	7400	7400			20.25	269	5447	5447	0001	24.02.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Verri, NJA: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
54	50	Llazi	Todi	Karoqja	VERRI	3752	56/18	Arë	7000	7000			5.6	269	1506	1506	0001	21.02.2022	Të dhënat e pasurisë janë përmirësuar përditësuar datë 18.10.2015	Fshati: Verri, NJA: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
55		Anastas	Koli	Kondakciu	VERRI	3752	56/19	Arë	5600	5600			14.65	269	3941	3941	0001	21.02.2022	Të dhënat e pasurisë janë përmirësuar përditësuar datë 18.10.2015	Fshati: Verri, NJA: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
56	51	Albert	Zaim	Etsi	VERRI	3752	56/2	Arë	7049	7049			17.14	269	4611	4611	001	21.02.2022	Me referencë 00134 bëhet RVP me vlerën 2897139 lekë. Të dhënat e pasurisë janë përmirësuar-përditësuar datë 4.2.2017	Fshati: Verri, NJA: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
57	52	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	92/8						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
58	53	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	215/14						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
59	54	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	215/1						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
60	55	Bedri/Luljeta/Klajdi/Rogerta	Metan/Kadri/Bedri/Bedri	Kumanaku	MBROSTAR URA	2636	5/6	Arë	7525	7525			9.11	269	2451	2451				Fshati: Mbrostar Ura, NJ A: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
61		Teki	Metan	Kumanaku	MBROSTAR URA	2636	5/7	Arë	12730	12730			10.25	269	2757	2757				Fshati: Mbrostar Ura, NJ A: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
62	56	Shqiponje/Ermir/Altin/Genci/Lindita/Aleksandra		Tabaku/Tabaku/Tabaku/Tabaku/Kocaqi/Toli	MBROSTAR URA	2636	13/6	Arë	17056	17056			20.25	269	5447	5447				Fshati: Mbrostar Ura, NJ A: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
63	57	Hajdar	Selim	Xhafa	MBROSTAR URA	2636	53/1	Arë	10193	10193			21.34	269	5740	5740				Fshati: Mbrostar Ura, NJ A: Mbrostar Ura, Bashkia Fier
64	58	Nuk ka informacion			MBROSTAR URA	2636	53/21						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
65	59	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	107/14						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
66	60	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	107/4						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
67	61	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	123/8						17.14		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022

68	**62**	Proces përditësimi			KALLMI I MADH	2050	127/2						20.25		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
69	**63**	Hysen		Emerllari	SHEQ I MADH	3981	21/1	Arë	10816	10816			17.14	269	4611	4611	0001	15.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
70	**64**	Entela		Çrraga	SHEQ I MADH	3981	22/13	Arë	3376	3376			14.97	269	4027	4027	0001	15.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
71		Tatjana		Çrraga	SHEQ I MADH	3981	22/14	Arë	4480	4480			2.17	269	584	584	00001	15.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
72	**65**	Nasi	Jorgji	Dashi	SHEQ I MADH	3981	29/41	Arë	1933	1933			20.25	269	5447	5447	0000001	23.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
73	**66**	Todi	Tonçi	Gjyrdiku	SHEQ I MADH	3981	141/15	Arë	4455	4455			21.34	269	5740	5740				Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
74		Gjylfizare	Mesllin	Ismaili	SHEQ I MADH	3981	138/10	Arë	4689	4689			6	269	1614	1614	00001	17.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
75	**67**	Shpresa	Hasan	Ismaili	SHEQ I MADH	3981	138/11	Arë	8147	8147			13.36	269	3594	3594	00009104	18.07.2012	Vendoset Sekuestro Konservative me shkresë nr. 208 prot. datë 6.6.2017 të Shoqërisë përmbarimore "CORR4ESCTOR " shpk Regjistruar: nr. 0001 datë 17.3.2022, Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
76	**68**	Nazmi	Qerim	Brakaj	SHEQ I MADH	3981	136/8	Arë	4578	4578			17.14	269	4611	4611				Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
77	**69**	Shtet			SHEQ I MADH	3981	149/1	Arë	1337	1337			49.7		0	0	000001	23.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
78		Albert	Kristaq	Daka	SHEQ I MADH	3981	149/2	Arë	3532	3532			14.3	269	3847	3847				Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
79	**70**	Vara		Tako	SHEQ I MADH	3981	277/11	Arë	2923	2923			19.36	269	5208	5208	0001	23.03.2022	Me Ref: 001622 lëshohet Certifikatë	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia

																		Pronësie dublikat datë 12.01.2011	Fier
80	71	Thoma	Miti	Tako	SHEQ I MADH	3981	277/9	Arë	3908	3908			36	269	9684	9684				Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
81	72	Adrian/Sejrida	Pandeli/Isuf	Gjika	SHEQ I MADH	3981	279/3	Arë	7652	7652			21.34	269	5740	5740				Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
82	73	Ndue	Lazer	Ndoja	SHEQ I MADH	3981	273/11	Arë	6894	6894			13	269	3497	3497	00001	16.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
83		Bukuroshe	Ethem	Bushi	SHEQ I MADH	3981	273/12	Arë	6828	6828			4.14	269	1114	1114	0001	16.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
84	74	Thoma	Kozma	Dushi	SHEQ I MADH	3981	272/5	Arë	3903	3903			18.18	269	4890	4890	0001	16.03.2022.	Përshkrim i veçantë me Ref: 003423, datë 10.2.2020 në bazë të shkresës nr: 718511 prot datë 6.9.2019 u bë konfirmimi në bazë të VKM 994 datë 09.12.2015	Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
85		Marije/Vasil/Pilo/Raimonda/Elvira/Lindita/Arben/Valentina	Ristan/Thoma/Thoma/Thoma/Thoma/Thoma/Thoma	Voli/Voli/Voli/Tyto/Kamxhiu/Voli/Voli/Llambro	SHEQ I MADH	3981	272/6	Arë	13076	13076			7.83	269	2106	2106				Fshati: Sheq i Madh, NJ A: Topoje, Bashkia Fier
86	75	Nuk ka informacion			MBYET	2637	288/112						19.36		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
87	76	Nuk ka informacion			MBYET	2637	288/125						19.01		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
88		Nuk ka informacion			MBYET	2637	288/126						7		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
89	77	Nuk ka informacion			MBYET	2637	224/7						19.36		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
90	78	Nuk ka informacion			MBYET	2637	223/5						21.34		0	0				Shkresa ASHK Fier 29.03.2022
91	79	Xhevit	Kamber	Rapushi	MBYET	2637	223/2	Arë	6515	6515			17.14	269	4611	4611	000001	23.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Mbyet, NJ A: Portez, Bashkia Fier
92	80	Nebi	Hekuran	Bako	MBYET	2637	221/15	Arë	1800	1800			17.14	269	4611	4611				Fshati: Mbyet, NJ A: Portez, Bashkia Fier
93	81	Flamur	Abaz	Kallashi	MBYET	2637	221/33	Arë	1000	1000			21.39	269	5754	5754				Fshati: Mbyet, NJ A: Portez, Bashkia Fier
94	82	Arshim	Azbi	Lamaj	MBYET	2632	233/30	Arë	2820	2820			17.14	269	4611	4611				Fshati: Mbyet, NJ A: Portez, Bashkia Fier
95	83	Vero	Bexhet	Buzi	DRIZE	1557	250/75	Arë	3536	3536			29.16	269	7844	7844				Fshati: Drize, NJ A: Qender, Bashkia Fier

96	**84**	Arif	Ymer	Merkaj	DRIZE	1557	249/20	Arë	3125	3125			12.45	269	3349	3349	00001	23.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Drize, NJ A: Qender, Bashkia Fier
97		Perparim	Arif	Merkaj	DRIZE	1557	249/21	Arë	2062	2062			23.55	269	6335	6335	00001	23.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Drize, NJ A: Qender, Bashkia Fier
98	**85**	Lio	Marko	Bare	DRIZE	1557	250/47	Arë	1748	1748			36	269	9684	9684	000001	23.03.2022	Plotësim dokumentacioni - për t'u pajisur me certifikatë pronësie	Fshati: Drize, NJ A: Qendër, Bashkia Fier
99	**86**	Irakli	Koci	Bare	DRIZE	1557	250/48	Arë	1312	1312			18.7	269	5030	5030				Fshati: Drize, NJ A: Qendër, Bashkia Fier
100		Zoi	Vangjel	Saramanda	DRIZE	1557	250/49	Arë	1078	1078			17.3	269	4654	4654				Fshati: Drize, NJ A: Qendër, Bashkia Fier
		SHUMA													**423,529**	**423,529**				

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 4 (1244), datë 23.6.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ferolland Kapxhiu, lindur më datë 26.7.1968, në Lushnjë, dhe banues në Njësinë Administrative Dushk, Bashkia Lushnjë, si dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të tij, kërkuesin Reshat Kapxhiu.

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Kuvendit nr. 74/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 67/2020, 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve', i ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr.132, datë 5.10.2022, në lidhjen 2, në pikën 5.1.1, fjalët "Sektori i Akteve dhe Konsulencës Ligjore" zëvendësohen me fjalët **"Sektori Hartimit të Akteve".**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 138
Datë: 2022/10/19 14:34:44
0e33f59e-0d82-4b28-807a-40183a0f0fa5

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë